

Fjalim i deputetit Sali Berisha

13.07.2023

Të nderuar qytetare dhe qytetarë,

Ky parlament sot mblidhet në shenjë të turpër historik. Mblidhet, kur shqiptarët dhe bota kanë mësuar se njeriu i dytë më i rëndësishëm i qeverisjes socialiste, Arben Ahmetaj është larguar, është arratisur nga vendi i tij, si një hajdut i damkosur, si një njeri që ka vjedhur, që e ka shfrytëzuar pushtetin për të vjedhur qytetarët e tij.

Megjithatë, mazhoranca në vend që të ulë kokën, të përdorë ndjesën, të kërkojë zgjidhje me largimin e kësaj qeverie, përkundrazi shpreh krenari, duartrokitje dhe rrahje gjoksi. E gjitha kjo nuk bëhet për Arben Ahmetajn, e gjitha kjo bëhet sepse Edi Rama në këtë aferë, duhet ta kemi të qartë, është shumëfishi i Arben Ahmetajt.

Të dashur qytetarë,

Sot me dhjetëra e qindra dokumente, të cilat u paraqitën në komisionin hetimor parlamentar, u paraqitën nga media dhe gazetarë të shumtë për këtë çështje, kanë faktuar katërcipërisht se kemi të bëjmë me një vjedhje të tmerrshme. Nga buxheti i shtetit janë marrë qindra milionë dollarë, euro, për të ndërtuar tre djegës, të cilët do të mjaftonin për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë dhe figuron vetëm një vjetërsirë në Elbasan që tre muaj punon dhe tre muaj nuk punon, dy djegësit e tjerë nuk janë kurrkund. Paratë tuaja kanë shkuar, por djegësit nuk ekzistojnë, se ato para janë vjedhur nga ‘arbenë ahmetër’, në proporcion. Natyrisht, vjedhjen më të madhe e ka bërë Edi Rama, që ka qenë njeriu më i angazhuar.

Ju duhet ta dini, se në datën 5 shkurt të vitit 2015, jo Lefter Koka, që si ministër i takonte të shkonte në zyrën e Kryeministrit, por Edi Rama dhe Engjëll Agaçi zbresin në zyrën e Lefter Kokës për të falsifikuar dokumentin. Në atë zyrë kishte pesë zëvendësministra të quajtur anëtarë të Komitetit të Emergjencave, që i kishte shpallur për të vjedhur Edi Rama. Për hir të së vërtetës, dy prej tyre nuk e firmosën. Ylli Manjani, dhe, në mos gaboj Arben Isaraj, nuk pranuan të firmosin me gjithë presionin që u bëri Edi Rama me Agaçin.

Edi Rama, për të krijuar terrenin për këtë vjedhje të madhe, mori çdo vendim fals, por, mbi të gjitha, ai krijoi kuadrin antiligjor mbi të cilin u bazua e tërë kjo vjedhje. Ky kuadër qëndron me firmën e tij, në kundërshtim me rekomandimin e Agjencisë Kombëtare të Prokurimeve Publike, që është me ligj dhe me Kushtetutë autoriteti përgjegjës ligjor në fushën e prokurimeve. Në kundërshtim me atë, Edi Rama firmosi t’i jepej “Zotos” (se Zoto nuk është asgjë tjetër, veçse agjenti i Edi Ramës), me negociatë të mbyllur, tenderi i Elbasanit.

Edi Rama hapi rrugën, të dashur qytetarë, krijoi mekanizmin e vjedhjes dhe tenderi, pa asnjë pjesëmarrje, iu dha atij që deshi Edi Rama me Engjëll Agaçin, Arben Ahmetajn, Lefter Kokën e me radhë.

Edi Rama është përgjegjësi kryesor, sepse dora e tij e zezë qëndron prapa prokurimit të djegësit të Fierit, me një çmim të dyfishtë me të Elbasanit.

Qytetarë dhe qytetare,

Djegësit e Fierit dhe të Elbasanit janë thjesht, strikt investim publik, janë paratë tuaja të

vjedhura nga qeveritarët për të blerë djegësit, në një kohë kur në ligj, në frymë dhe në gërmë, ato detyrime duhet t'i bënin Bashkia e Fierit dhe Bashkia e Elbasanit. Po pse nuk iu dha bashkive të Fierit dhe të Elbasanit t'i bënin tenderët? Sepse, duke ia dhënë firmës së tyre "Zoto", tenderi i Elbasanit u mbyll me 9 apo 10 milionë euro, dhe 10 milionë euro tepruan në xhepat e Ramës dhe të ministrave të tij. Kurse sa i përket tenderit të Fierit, nuk iu dha Bashkisë së Fierit të bënte tenderin, iu dha përsëri "Zotos", por tani iu dha dyfishi (se oreksi vjen duke ngrënë) dhe nuk mbetën më 10 milionë euro në xhepat e Ramës dhe të qeveritarëve, por mbetën 23 milionë euro.

Po si mund t'i dilni zot ju kështu? A e dini ju që ju ndjekin edhe familjarë, rrethi juaj, por nuk pajtohen kurrë me këto qëndrime? A e dini ju këtë gjë, apo jo?

Ç'bëri pastaj Edi Rama? Pse është Edi Rama, njeriu më kryesor? Sepse oreksi vjen duke ngrënë, vodhën këtu 20, tjetrin e bënë 40 e ca, tani duhen 120. A, 120?! E gjetën mekanizmin në koncension! A e dini ju që Erion Veliaj ka falsifikuar, ka firmosur për këshillin bashkiak dhe për këshillin e Qarkut të Tiranës? Ka firmosur për 5 bashki, në një kohë kur të katërta kanë qenë kundër, dhe këtë e ka bërë totalisht me miratimin e Edi Ramës. Arben Ahmetaj nuk e ka firmosur, por nuk del kurrë jashtë përgjegjësisë, se për një zyrtar, ligji është veprim dhe mosveprim, aq më tepër që ai e dinte që po shkelej me dy këmbë, por Edi Rama diktonte dhe natyrisht ndante copa.

Pra, tani, pas 6 vjetësh të kontraktimit të djegësit të Tiranës, nuk ekziston asnjë objekt i ndërtuar, zero objekte, në një kohë kur janë dhënë mbi 100 milionë euro. Kanë përfunduar të gjitha në xhepat e Erion Veliajt, të Edi Ramës dhe të çetës së tyre të hajdutëve. Asnjë aferë nuk ka përfshirë... Juve do t'ju djegin flakët, ja, jua them unë këtu, mbajeni mend, do t'ju djegin flakët e djegësve që nuk u ndërtuan! Është e vështirë të gjesh njërin prej jush që nuk ka... Ja, tani po lexoja: Zoto paska qenë këshilltari i Salarjanit, apo si quhet ai, bashkëshorti i Elisës. Nuk ka vend që nuk gjendet, në çdo sirtar, ja ku e kam vendimin këtu.

Dil, dil dhe lexoje pak! Nuk ka vend, në çdo sirtar tuajin që të hapni, ju del Zoto, ju del Mërtiri.

Dhe ty, Ulusi, do të të dalë diku, po nuk ka se si, nuk mund të jesh përjashtim ti.

Atje, te krimi elektoral, atje e ke absolutisht ti, do të dënohesh deri në ditët e fundit të jetës, ke për ta parë. Jo, jo, ke për ta parë, u thuaj të të bëjnë një vend gati atje, se atje do të shkosh ti.

Pra, këta janë të gjithë të implikuar. Dhe këta, në vend që të dënojnë, të paktën ata që nuk janë të implikuar, mbrojnë Edi Ramën. Ku është ai sot? Si mund të pranoni ju, që të mos jetë ai këtu sot? Ia mbathi edhe ai, ia mbathi. Ai tjetri u arratis, edhe ky diku tjetër fshihet tani.

Pra, e kuptoni ju që me mungesën e tij, ai nxin. Afera shkon në 720 milionë euro dhe nuk tërhiqeni, dhe Prokuroria nuk guxon të konfiskojë veprat e krimit, nga presioni juaj.

Mbaroi koha, po vjedhjet tuaja nuk mbarojnë kurrë! Koha mbaroi, por vjedhjet tuaja nuk mbarojnë kurrë.